



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 259/1 Prot.

Tiranë, më 05. 03. 2019

V E N D I M

Nr. 34, Datë 05. 03. 2019

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën Nr. 15, datë 18.02.2019, e E. B., ku pretendon diskriminim të fëmijëve të saj për shkak të *“racës, gjendjes ekonomike dhe arsimore”*¹ nga ana Bashkia Shkodër, Gjykata e Apelit Shkodër dhe Shtëpia e Fëmijës 0-6 vjeç Shkodër.

Pas shqyrtimit fillestar të ankesës së mësipërme, Komisioneri,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Mbështetur në informacionin që përmban formulari i ankesës dhe dokumentacioni bashkëlidhur saj, rezulton se ankuesja është banore e qytetit të Shkodrës dhe prind i 7 (shtatë) fëmijëve. Aktualisht ajo jeton në kampin e ndërtuar nga komuniteti rom pranë Urës së Bahçallekut në Shkodër. Për të siguruar mjetet e jetesës, ankuesja sqaron se është e detyruar të lyp në rrugët e qytetit.

Mbështetur në shkresën Nr. 8753 prot., datë 04.06.2018, të Njesisë së Mbrojtjes së Fëmijës, Bashkia Shkodër, gjatë periudhës 2016-2018, ankuesja është identifikuar në rrugët e qytetit duke lypur së bashku me fëmijët e saj të mitur. Së fundmi, më datë 01.06.2018, Njësia e Mbrojtjes së Fëmijës, ka konstatuar sërish ankuesen duke lypur së bashku me fëmijët e saj të mitur,

¹ Ankuesja është vetdeklaruar pjesë e komunitetit rom

përkatësisht shtetasit: S. B. i moshës 5 (pesë) vjeç dhe R. B. i moshës 4 (katër) vjeç. Nga ana e kësaj strukture, janë marrë masat emergjente të mbrojtjes së fëmijëve, duke i dërguar fëmijët në Shtëpinë e Fëmijës 0-6 vjeç Shkodër, si dhe nga ana e strukturave të Policisë së Shtetit është shoqëruar E. B., në ambjentet e policisë. Që nga ky moment, Bashkia Shkodër i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, duke kërkuar konfirmimin e masës mbrojtëse të përkohshme për vendosjen e fëmijëve në përkujdesje alternative dhe vendosjen e fëmijëve në kujdestarinë e përkohshme pranë një institucioni të përkujdesit shoqëror.

Në përfundim të gjykimit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, pas vlerësimit të rrethanave dhe situatës së paraqitur, ka vendosur që 2 (dy) fëmijët e ankueses të vendosen në kujdestari të përkohshme pranë Shtëpisë së Fëmijës 0-6 vjeç Shkodër.

Përsa më sipër, ankuesja shprehet se strukturat e Bashkisë Shkodër, kanë vepruar në mënyrë të padrejtë duke i marrë fëmijët, pasi nuk ka qënë duke shfrytëzuar fëmijët e saj për të lypur. Në momentin e konstatuar nga ana e Njesisë për Mbrojtjen e Fëmijës, ajo pranon që ka qënë duke lypur, por pretendon se i ka patur fëmijët me vete për shkak se nuk kishte ku ti linte për shkak të moshës së tyre.

Gjithashtu, ankuesja sqaron se punonjësit e Njesisë për Mbrojtjen e Fëmijës, kanë vepruar në mënyrë të padrejtë duke i marrë fëmijët e saj në mënyrë të dhunshme dhe duke i hequr kujdestarinë.

Sa i përket shoqërimit në Drejtorinë Vendore të Policisë Shkodër, ajo pretendon se është dhunuar fizikisht dhe psikologjikisht sa është dashur asistencë mjekësore.

Në pretendimet e saj, ankuesja ka sqaruar se nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër janë ndjekur procedura diskriminuese për shkak të përkatësisë së saj në komunitetin rom, mungesën e arsimit dhe fakti që nuk ka vendbanimin në qytetin e Shkodrës.

Gjithashtu, E. B. ka pretenduar se fëmijët e saj të vendosur pranë Shtëpisë së Fëmijës 0-6 vjeç Shkodër, janë shprehur se keqtrajtohen dhe mbi ta ushtrohet dhunë fizike dhe psikologjike nga ana e strukturave të këtij institucioni.

Në këtë kontekst, E. B. ka kërkuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi:

- Verifikimin e të gjitha procedurave të Bashkisë Shkodër të cilat kanë sjellë marrjen e fëmijëve dhe dërgimin e tyre në Shtëpinë e Fëmijës 0-6 vjeç Shkodër,
- Verifikimin e punonjësve të Bashkisë Shkodër, që kanë trajtuar rastin e saj dhe nëse ata kanë patur përgjegjësi për marrjen dhe dërgimin e fëmijëve të saj në Shtëpinë e Fëmijës 0-6 vjeç Shkodër,

- Marrjen e masave për çdo procedurë gjyqësore që nuk është bërë ashtu siç parashikon ligji, duke u diskriminuar për shkak të përkatësisë në komunitetin rom, mungesës së arsimit dhe vendbanimit në qytetin e Shkodrës,
- Të mos ushtrohet dhunë fizike dhe psikologjike ndaj fëmijëve të saj, gjatë kohës që qëndrojnë në Shtëpinë e Fëmijës 0-6 vjeç Shkodër.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës u konstatua se:

Plotësimi i kriterëve formale të një ankese, për të vijuar me shqyrtimin administrativ të saj, është hapi i parë, që ndiqet nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në bazë parashikimeve përkatëse ligjore. Ky detyrim i Komisionerit parashikohet shprehimisht në ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, si dhe në ligjin Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.

Mbështetur në parashikimin e nenit 44, pika 2, të ligjit Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” organi publik shqyrton paraprakisht kërkesën e depozituar nga pala, lidhur me përmbushjen e kriterëve formale ligjore, si kompetenca e organit publik, legjitimitimi, afati, forma dhe çdo kriter tjetër të parashikuar nga ligji.

Në nenin 1 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” në nenin 3, pika 1, si: *“Çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”*.

Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi ndalon situatat kur persona ose grupe personash në një situatë të njëjtë trajtohen në mënyra të ndryshme, dhe situatat kur personat ose grupet e personave në situata të ndryshme trajtohen njësoj.

Bazuar në nenin 7 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi apo mosveprimi si të një autoriteti publik, ashtu edhe çdo personi fizik apo

juridik që merr pjese në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë.

A. Lidhur me veprimet e kryera nga ana e Bashkisë Shkodër dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër

Ankuesja në rastin në fjalë, ka paraqitur informacion lidhur me problematikën që ka patur me Bashkinë Shkodër, lidhur me procedurat e Bashkisë Shkodër të cilat kanë sjellë marrjen e fëmijëve dhe dërgimin e tyre në Shtëpinë e Fëmijës 0-6 vjeç Shkodër, por nuk ka paraqitur fakte për të provuar se veprimet e kryera nga ana e Bashkisë Shkodër janë bërë për shkak të “racës, gjendjes ekonomike dhe arsimore, familjare” që ankuesja ka.

Gjithashtu, sa i përket veprimeve të kryera nga ana e Bashkisë Shkodër dhe strukturave të saj për marrjen dhe dërgimin e fëmijëve në Shtëpinë e Fëmijës 0-6 vjeç Shkodër, është një procedurë e shqyrtuar nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

Neni 43 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, parashikon se: *“Kushdo ka të drejtë të ankohet kundër një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në ligj për kundërvajtje të lehta penale, për çështje civile ose administrative me rëndësi ose vlerë të vogël, në përputhje me kushtet e parashikuara në nenin 17 të Kushtetutës”.*

Përsa më sipër dhe referuar informacionit² të marrë në faqen zyrtare web të Gjykatës së Apelit Shkodër, konstatohet se Bashkia Shkodër ka paraqitur ankim në këtë gjykatë, për kundërshtimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër. Pra, në këto kushte verifikimi i procedurave të ndjekura nga ana e Bashkisë Shkodër lidhur me marrjen dhe dërgimin e fëmijëve në Shtëpinë e Fëmijës 0-6 vjeç Shkodër, ka qënë objekt gjykimi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër.

Neni 36, i Ligjit Nr. 8116, datë 29.03.1996 *“Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”*, në paragrafin 3, parashikon se: *“...Asnjë institucion tjetër nuk ka të drejtë të pranojë për shqyrtim një mosmarrëveshje civile që është duke u gjykuar nga gjykata...”*

Mbështetur në legjislacionin e sipërcituar dhe në kushtet që procedura e ndjekur nga ana e Bashkisë Shkodër dhe vendimi i marrë nga ana Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, është në proces shqyrtimit nga Gjykata e Apelit Shkodër, në këtë situatë Komisioneri vëren se kjo kërkesë nuk bën pjesë në kompetencat dhe fushën e veprimit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Pra, Komisioneri nuk mund të marrë në shqyrtim apo të hetojë mbi procedurën e ndjekur nga ana e Bashkisë Shkodër apo procesin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

²<http://www.gjykata.gov.al/apel-shkod%C3%ABr/gjykata-e-apelit-shkod%C3%ABr/c%C3%ABshtjet-gjyq%C3%ABsore/c%C3%ABshtjet-civile/>

B. Lidhur me veprimet e kryera nga ana e Shtëpisë së Fëmijës 0-6 vjeç Shkodër

Përsa i përket pretendimeve të ngritura, për ushtrim dhune fizike dhe psikologjike ndaj ankueses në ambientet e Drejtorisë Vendore të Policisë Shkodër dhe ndaj fëmijëve në Shtëpinë e Fëmijës 0-6 vjeç Shkodër, ankuesja nuk ka paraqitur asnjë fakt dhe provë apo shpjegime lidhur me këtë pretendim. Megjithatë, në referim të të dhënave të paraqitura nga subjekti ankues vërehet se pretendimet e saj janë bazuar në denoncimin e veprimeve të dhunshme nga ana e strukturave të Drejtorisë Vendore të Policisë Shkodër dhe Shtëpisë së Fëmijës 0-6 vjeç Shkodër, dhe jo si pretendime për trajtim të pabarabartë në raport me të shtetas të tjerë.

Ligji Nr. 7895, datë 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, në nenin 90, parashikon se: “Rrahja, si dhe çdo vepër tjetër dhune, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë. Po kjo vepër, kur ka shkaktuar paaftësi të përkohshme në punë deri në 9 ditë, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në gjashtë muaj”.

Referuar për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se veprimet e jashtëligjshme të personave që ushtrojnë funksione publike parashikohen si vepër penale në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë dhe pala ka të drejtë ti denoncojë këto veprime pranë organeve kompetente.

Për sa më sipër, Komisioneri vëren se, ankuesja dhe fëmijët e saj mund të jenë vënë përpara veprimeve ose mosveprimeve të paligjshme të strukturave të Drejtorisë Vendore të Policisë Shkodër dhe Shtëpisë së Fëmijës 0-6 vjeç Shkodër, por në bazë të rrethanave të shpjeguara dhe shkaqeve të pretenduara nga ankuesja, nuk ka informacion të mjaftueshëm që të lejojë shqyrtimin e mëtejshëm të çështjes lidhur me objektin e Ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

Për sa më sipër, referuar nenit 33 pika 4/b të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” i cili citon se “Ankesa nuk pranohet nëse është e pajtueshme me dispozitat e këtij ligji”, ankesa nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenet 3, 12, 20, 21, pika 1, neni 32, pika 1, gërma a), nenin 33, pika 4, gërma b) të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës Nr. 15, datë 18.02.2019, së E. B., pasi nuk është e pajtueshme me dispozitat e Ligjit Nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

Konceptoi: R.Babaj

Sigloi: V. Bushati

Date: 27.02.2019